

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“Alice in Paris Group” sh.p.k.

Sot më 14.02.2022, në Tiranë, unë:

- **Znj. Anastasia Krivosheeva**, shtetase e huaj, lindur në ish Bashkimin Sovjektik (aktualisht Federata Ruse), në 31.07.1984, mbajtëse e pashaportës Nr. 530859367, lëshuar në datën 09.04.2015 dhe e vlefshme deri në datën 09.04.2025, me adresë banimi Kodra e Diellit 2, Tiranë, Shqipëri, bazuar në vullnetin tim të lirë, Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin Civil, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, kam vendosur që, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, të themeloj shoqërinë "**Alice in Paris Group**" sh.p.k.

NENI 1

1.1 Shoqëria themelohet me emrin "**Alice in Paris Group**" sh.p.k., emër i cili do të pasqyrohet edhe në vulën zyrtare të shoqërisë. Shoqëria "**Alice in Paris Group**" sh.p.k. mund të përdorë emrin "**Alice in Paris Group**" sh.p.k. ose emrin tregtar të shkurtuar **AP sh.p.k.** Këtu e më poshtë në këtë Akt Themelimi, shoqëria "Alice in Paris Group" sh.p.k. do të referohet vetëm si shoqëria.

NENI 2

2.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, me adresë Kodra e Diellit 2, Tiranë, Shqipëri.

NENI 3

3.1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë ose jashtë tij.

NENI 4

4.1. Kapitali themelues i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

4.2. **Znj. Anastasia Krivosheeva**, shtetase e huaj, lindur në ish Bashkimin Sovjektik (aktualisht Federata Ruse), në 31.07.1984, mbajtëse e pashaportës Nr. 530859367, lëshuar në datën 09.04.2015 dhe e vlefshme deri në datën 09.04.2025, me adresë banimi Kodra e Diellit 2, Tiranë, Shqipëri, është zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 5

5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat, që fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

6.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në legjislacionin shqiptar si dhe në Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.



NENI 7

7.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, përfshirë dhe pa u limituar në kryerjen e aktiviteteve tregtare të importit, eksportit, shpërndarjes, sigurimit dhe shfrytëzimit të ekskluzivitetit, shitjes me shumicë dhe pakicë, zhvillimit të franchise, funksionimit si agjent shitjeje dhe tregtar, për produket e mëposhtëme: veshmbathje të të gjitha llojeve dhe për të gjitha moshat; tekstile të të gjitha llojeve; aksesorë shtëpiakë të të gjitha llojeve; dekor ambientesh të brendshme dhe te jashtme si dhe objekte porcelani të të gjitha llojeve.

7.2. Organizim, zhvillim dhe drejtim të aktiviteteve promocionale dhe reklamuese të produkteve të mësipërme si dhe në funksion të tyre.

7.3. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të plotësohen objektivat e shoqërisë, shoqëria mund të zhvillojë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, huamarrije për investime dhe/ose financim të aktiviteteve të shoqërisë, vendosje të pengjeve dhe barrave hipotekore, aktivitete këto të konsideruara në funksion të plotësimit të objektivave të shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet principale të cituara më sipër.

7.4. Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si dhe çdo formë e aktiviteteve ligjore dhe komerciale që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

NENI 8

8.1. Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik dhe të drejtën për të ushtruar aktivitete si dhe për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, vetëm pas rregjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 9

9.1. Organi drejtues më i lartë i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**, e cila operon në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.

NENI 10

10.1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2. Në aktin e emërimit, përcaktohet edhe periudha e ushtrimit te funksionit, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 11

11.1. Administratori i shoqërisë është **Z. Uran Shtylla**, lindur në Durrës, Shqipëri, në 12.09.1982, mbajtës i pashaportës Nr. BG0253777, lëshuar në datën 25.10.2019 dhe e vlefshme deri në datën 24.10.2029, me Nr. Personal I20912055L, me adresë banimi Kodra e Diellit 2, Tiranë, Shqipëri, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.



NENI 12

12.1. Detajet në lidhje me menaxhimin e Kapitalit themelues, transferimin, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, menaxhimin administrativ të shoqërisë, balancat kontabël dhe financiare, falimentimin si dhe likuidimin etj., janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e shoqërisë.

NENI 13

13.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën përbajtje dhe vlerë ligjore dhe, pasi u lexua, kuptua dhe u miratua në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë "Alice in Paris Group" sh.p.k., nënshkruhet nga ai dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË "ALICE IN PARIS GROUP" sh.p.k.

MIRATIMI I KËTIJ AKT THEMELIMI NGA:

Znj. Anastasia Krivosheeva

Nënshkruar sot, më 14.02.2022

ANASTASIJA KRIVOSHEEVA

